Klasa 6–9

UDHËTIMI nëpër INTERNET

UDHËTIMI nëpër INTERNET

Udhëzues për fëmijë/nxënës të klasave 6-9 të arsimit të mesëm të ulët

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstva za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

Prishtinë, 2017

Udhëtimi nëpër internet

Autoret: Mimoza Hasani Pllana
Merita Januzi

Redaktore: Shqipe Z. Gashi

Lektore: Afërdita Kryeziu

Kontribuesit:
Alush Istogu
Faton Fetahu
Avni Rexha
Veton Alihajdari
Teuta Zymeri
Habibe Buzuku
Shkëndije Nagafci
Edi Puka
Shpresa Shala
Bislim Krasniqi
Minire Gashi

Fotogra a: Norik Uka
Dizajni dhe ilustrimet: Leopard Cana

Botues: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT)

Të gjitha të drejtat për ribotim i përkasin MAShT dhe autoreve

https://www.masht.rks-gov.net

Përmbajtja

1. INTERNETI 6

2. PSE UDHËTOJMË DHE SI? 11

2.1. Mësimi 12
2.2. Kërkimi i informacionit 13
2.3. Komunikimi dhe bashkëpunimi 14
2.4. Argëtimi 15

3. TË ECIM ME KUJDES! 16

3.1. Dhuna digjitale 16
3.2. Tra kimi me njerëz 17

4. KËSHILLA TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË NË INTERNET 18

4.1. Shmangu nga dhuna digjitale! 19
4.2. Mos komuniko me persona të panjohur në internet! 22
4.3. Ruajfjalëkalimet dhe të dhënat tua personale! 24
4.4. Kujdes si përfshihesh në rrjetet sociale! 25
4.5. Kujdes në lojërat online! 27

5. ARRITJA 28

Përfundim 30

1. Interneti

I dashur nxënës (fëmijë),

Sot po jetojmë në kohën e zhvillimeve të hovshmetë teknologjisë dhe komunikimi digjital thuajse zë vendin e parë në relacion me çdo lloj komunikimi tjetër. Tani më përdorimi i internetit ka përfshirë përmasa të mëdha në çdo nivel, si në familje, ashtu edhe në shkollë e kudo. Por, aq sa janëmundësitë e mëdha të përdorimit, aq janë edhe mundësitë e keqpërdorimit dhe të abuzimit. Në klasat paraprake të arsimit tënd ti ke marrë udhëzuesin e parë për përdorimin e duhur të interentit dhe tani ky udhëzues të plotëson informacionet mbi sjelljet e duhura për shmangien e rreziqeve që mund të kanosen gjatë përdorimit të internetit.

E kemi parasysh që jetojmë në epokën digjitale, andaj të duhet përkushtim maksimal në përdorimin e drejtë dhe racional të internetit dhe teknologjisë informative në përgjithësi. Fëmijët anë e kënd botës po shpenzojnë shumë kohë në internet dhe shpesh qëllimet e përdorimit nuk janë në suazat e normales, gjë që po ndikon negativisht në rritjen e mbarë e të suksesshme të tyre. Përveç që shfrytëzohet shumë kohënë rrjete sociale dhe në chat, pa i njohur mirë rregullat e përdorimit, minimizimi i kohës së leximit të librave shkollorë dhe qëndrimi i gjatë ulur e pa aktivitete zike rezulton me uljen e rezultateve të arritshmërisë, si dhe me rreziqe për shëndetin.Kështu që, përfundimisht dëmet janë sa zike, aq edhe intelektuale.

Shpesh fëmijët dhe adoleshentët nuk janë të vetëdijshëm për veprimet e tyre online dhe për pasojat negative psikologjike dhe sociale që i sjellin ato, qoftë atyre personalisht, familjeve apo edhe shoqërisë në përgjithësi. Rreziqet e përdorimit të internetit, përfshirë: përmbajtjet e dëmshme, dhunën/ ngacmimet digjitale, takimet me njerëz të panjohur, publikimin i të dhënave personale në pro let e tyre, etj., do të trajtohen me kujdes brenda këtij libri , i cili do të të ofrojë udhëzime përmbajtësore,në mënyrë që ta krijosh një kulturë të qëndrueshme dhe të dobishme të përdorimit të teknologjisë informative.

Pasi t`i kesh përvetësuar dhe ndjekur udhëzimet, do të udhëtosh sigurt në internet, duke për tuar mësime e informata të reja, lojë e argëtim siç duhet, si dhe komunikim me miq e familjarë, njëherit do tëshijosh mundësitë dhe botën magjike që ofron interneti.

Sh etimi i faqeve të internetit (anglisht: webBrowsing) bëhet duke përdorë programet, si: Internet Explorer, Safari, Firefox, Opera, Google Chrome e të ngjashme, në të cilat mund të gjesh tekste, fotogra , muzikë, video, lojëra etj.

Rrjetet sociale mundësojnë shoqërimin, komunikimin, debatimin, si dhe shkëmbimin e mesazheve, fotogra ve e videove në suazat e interesimeve individuale dhe grupore. Ato përdoren nga të gjitha shtresat e moshat, por përdoruesit më të mëdhenj kryesisht janë fëmijët/adoleshentët. Rrjetet sociale si dhe aplikacionet tjera plotësohen me forma të reja komunikimi përgjatë evoluimit (zhvillimit) të teknologjisë. Disa nga rrjetet sociale të pëlqyera dhe përdoruara nga fëmijët/adoleshentët janë: Instagram, Facebook, Whats App, Snapchat etj.

Motorët e kërkimit

Google, ASK, Bing, Yahoo, Aol, etj. janë motorë kërkimi, të cilët ofrojnë shërbime sipas kërkesës tuaj, si: faqe interneti, informacione, fotogra , harta, diskutime në forume online, përdorim të emailit etj. Përdorimi i Google dhe motorëve tjerë shërben për për timin e njohurive të reja në çdo fushë. Për të kuptuar më shumë rreth tyre, në bashkëpunim me mësuesin/en apo prindërit, vizito faqet dhe hulumto për interesimet tua.

Mbaj mend!

Sygjerojmë që kërkimin e videove ta bësh përmes aplikacionit Youtube Kids. Ndryshe nga Youtube, Youtube kids ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga shfaqjet e videove me përmbajtje të papërshtatshme.

Mbaj mend!

Loja Minecraft education është një lojë tërheqëse për fëmijët dhe ofron mundësi të shumta përdorimi për qëllime arsimore. Minecraft mund të përdoret në shkolla, me ç'rast nxënësit bashkë me mësuesit mund të krijojnë aktivitete të ndryshme brendafushave të caktuara, si: gjuhë, matematikë, shkencë, arte dhe fusha tjera të cilat i ofron Minecraft education. Në bashkëpunim me mësuesit përcakto interesimet tua dhe puno brenda fushës së përcaktuar bashkarisht.

E-mail (adresa elektronike) është një nga shërbimet e para që ofron interneti, por që përdoret shumë edhe sot. E-mail mund të krijojë çdo i interesuar, llimisht duke gjetur faqen që ofron krijimin e-emailit, si: google, yahoo, outlook, o ce 365, etj. Prandaj, ndiq hapat që gjen te linku Sing-up (krijo llogari të re). E-mailin duhet ta përdorësh me kujdes dhe me përgjegjësi.Nuk duhet tëpërdorësh fjalë fyese e të dëmshme për ty dhe për asnjë njeri tjetër që është pjesë e komunikimit.

Chat-i të ofron mundësi të komunikimit me personat që janë online dhe perms tij mund të zhvillohet një lloj bisede e drejtpërdrejtë me një person tjetër apo me një grup personash tjerë.Komunikimi mund të realizohet kur dy apo më shumë persona janë duke e përdorë chat-in në të njejtën kohë (online), apo kur ata janë duke e përdorë chat-in në kohë të ndryshme (informata ruhet edhe kur tjetri është o ine). Në rastin e parë komunikimi është më i shpejtë se në rastin e dytë.Ashtu si edhe në komunikimet e tjera,edhe ne chat tësygjerojmë që gjatë komunikimit të përdorësh gjuhë miqësore dhe jo fyese. Gjithashtu, përdore gjuhën standarde, respekto shenjat e pikësimit dhe rregullat e drejtshkrimit. Në këtë mënyrë do të arrish të jesh i qartë dhe i kuptueshëm nga bashkëbiseduesi dhenuk do të krijosh keqkuptime.

Përdore chat-in vetëm për komunikim me njerëz të njohur. Komunikimi me njerëz të panjohur paraqet shumë rreziqe. Prandaj, kujdes!

Forumet janë vendet/hapësirat ku njerëzit vendosin informata, mesazhe dhe mendime të tyre për tema të caktuara. Sipas moshës mund të marrësh pjesë në forume, duke treguar interesimet dhe njohuritë tua në tema e fusha të ndryshme. Përgjigjet që merr në forume mund të jenë të pasakta. Prandaj, mos i përdor ato si burime informacioni, pa e vërtetuar saktësinë e tyre. Nëse dëshiron të bëhesh pjesë e formumeve, kujdes gjuhën që përdor dhe drejtshkrimin, meqë diskutimet janë publike dhe mund të lexohen nga çdokush.

Mbaj mend!

Informatat që lexon në forume mund të jenë të pasakta.



2. Pse udhëtojmë dhe si?

Duke ecur nëpër rrugën e dijes, krahas mësimeve në shkolla, leximit të librave, revistave e gazeta të ndryshme, ti shfrytëzon mundësitë që i ofrojnë bibliotekat e libraritë e ndryshme, si dhe pashmangshëm edhe internetin si burim të pashtershëm informacioni në kohën e sotme digjitale. Mosha jote e re kërkon të përmbushet me dije e informata që do të duhen gjatë gjithë jetës, në të mirën tënde individuale (personale) dhe atë kolektive (familjare dhe shoqërore). Përgjatë këtij udhëtimi drejt zhvillimit tënd të plotë të duhen edhe loja, argëtimi dhe komunikimi i mirë. Mirëpo, meqë bëhet fjalë për interentin, duhet të kesh kujdes kohën dhe mënyrën e përdorimit.

Qëllimet mund të jenë:

Meqë të duhen mësime e informata në vazhdimësi, caktoje qëllimin tënd të përdorimit të internetit si burim i shpejtë dhe lehtësisht i qasshëm dhe përdore atë në mënyrë të përgjegjshme!

Mbaj shënim!

Listo qëllimet tua për përdorim të internetit:

.....

.....

.....

.....

Kohëzgjatja:
30 min.

2.1 Mësimi

Interneti të ofron mundësi të mëdha mësimi. Shfrytëzoje atë sa të jetë e mundur për informata të reja rreth mësimeve që të nevojiten në shkollë dhe në jetë. Mjafton ta shënosh në Google temën që të intereson dhe do të gjesh një mori informatash dhe fotogra sh që mund të të ndihmojnë për ta pasur më të qartë temën e caktuar.

Mbajmend!

Përmes internetit mund të zgjerosh njohuritë në fusha të ndryshme, si dhe mund të mësosh gjëra interesante për vende dhe popuj të ndryshëm.

Aktiviteti 1

Kërko në internet krijimtarinë e autorit/es që të pëlqen, nga cilado fushë. Pasi të kesh hapur faqet me informatat e nevo-jshme, regjistro ato kryesoret dhe listo veprat e autorit/es që zgjodhe!

Mbaj shënime!

Autori /ja që më pëlqen është:

.....

Ai/ajo shquhet për:

.....

Veprat e tij/saj janë:

.....

.....

.....

Diskutoni në klasë dhe në familje për veprat dhe autorët që të pëlqejnë, duke evidentuar karakteristikat, vlerat dhe arritjet e tyre.

Kohëzgjatja: **30 min.**

2.2 Kërkimi i informacionit

Duke lexuar tekstet e cilësdo lëndë mësimore, dalin kërkesa të vazhdueshme për informacione shtesë dhe sipas referencave që gjenden në tekst mund ta nisësh kërkimin në internet për gjërat që të interesojnë. Në motorët e kërkimit, si: Google, Yahoo, Bing, etj. e merr shpejt informatën që gjendet në web-site e vegëza (linqe) të ndryshme, të cilat mund t`i shfrytëzosh si burim informacioni. Por, gjithnjë duhet ta kesh parasysh arsyen dhe qëllimin e kërkimit, për të mos humbur rrugën, kohën dhe cakun e kërkimit.
Kërkimi i informacionit për arsye mësimi e zhvillimi të bën më të fortë në arritjen e rezultateve që kërkohen në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, duke të radhitur në rangun e nxënësit të suksesshëm/ nxënëses së suksesshme, me të menduarit kreativ/krijues dhe kritik, me fuqinë e njohjes së realitetit që të rrethon dhe me sjelljet e shëndosha e të përgjegjshme të cilat të mbajnë larg rreziqeve eventuale dhe rrethanave të padëshiruara.

Mbaj mend!

- Cakto kohën e pushimit nga mësimi/kërkimi dhe luaj në natyrë, që të kesh shëndet të mirë!
- Klikimi mbi faqet që nuk i ke kërkuar mund të të shpie para materialeve të papërshtatshme dhe të dëmshme.
- Shikimi i pamjeve të papërshtashme mund të dëmtojë shëndetin tënd emocional dhe zik.

Aktiviteti 2

Vendose një cak kërkimi në cilëndo fushë që të duhet! Pastaj, kërko në motor kërkimi temën e caktuar dhe pasi ta gjesh informatën, shëno gjërat që janë me interes për cakun e kërkimit tënd. Diskutoji me shokë e shoqe të rejat që i mësove nga interneti!

Mbaj shënime!

.....

.....

.....

Kohëzgjatja:
30 min.

2.3 Komunikimi dhe bashkëpunimi

Nëpërmjet internetit (përmes aplikacioneve të njohura për komunikim dhe bashkëpunim, si: E-mail, Chat, Skype, rrjete sociale, viber etj.) mund të komunikosh me familjarët, shokët e klasës e miqtë tjerë për të shkëmbyer informatat që të duhen rreth familjes, mësimeve, shoqërisë.
Mësimet e rregullta në shkollë të mësojnë mënyrat e komunikimit dhe të zhvillojnë aftësinë e shprehjes me çfarëdo niveli nëpërmjet përdorimit të gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike, duke i shfrytëzuar në mënyrë të pavarur mundësitë dhe alternativat e komunikimit. Kështu, këto forma mund t`i vësh në përdorim në suazat e bashkëpunimit në distancë, në relacione të ndryshme ndërmjet nxënësve, shkollave etj.
Atëherë, ti nxënës/e i/e mirë, duhet ta kuptosh që komunikimi i vrazhdë, i rëndë dhe fyes nuk duhet të jetë pjesë e të shprehurit në përditshmërinë tënde, ngase ky lloj komunikimi bën që ti të jesh në mesin e njerëzve kon iktuoz, të bezdisshëm dhe të papranueshëm për rrethin shoqëror. Gjithashtu, komunikimi i keq nxit dhunë, kon ikt e pakënaqësi dhe askush brenda atij komunikimi nuk ndihet mirë. Përkundrazi, dëmet dhe pasojat i bartin të gjitha palët e përfshira në atë lloj komunikimi.

Aktiviteti 3

Lisi kishte fotografuar shoqen e klasës dhe atë foto e kishte përpunuar në kompjuter me qëllim të përqeshjes dhe ngacmimit.
Një ditë ai e vendosi foton e saj në Facebook me mbishkrimin:
“Kjo vajzë është nxënëse e klasës VI. Çka mendoni për të?”

Mbajmend!

Komunikimi i mirë është vlerë njerëzore! Komunikimi i keq ndikon negativisht në marëdhëniet tua me të tjerët. Keqpërdorimi i të dhënave personale është i dënueshëm me ligjet tona dhe me ato ndërkombëtare.

2.4 Argëtimi

Argëtimi nëpërmjet lojërave është me interes për zhvillimin tënd të shëndetshëm. Interneti përmban lojëra shumë të mira edukative, të cilat të ndihmojnë në arritjet tua në mësime. Ato të fusin në botën e bukur përrallore dhe të bëjnë të shkathët në shumë drejtime. Përveç lojërave, aty mund të gjesh lma, muzikë të preferuar, të cilat të zgjojnë ndjenjën e së bukurës artistike dhe të zgjojnë kreativitetin për krijime në ato fusha.
Vetë argëtimi të ndihmon në zhvillimin psiqik dhe emocional të qëndrueshëm, si dhe në zhvillimin e shkathtësive drejt arritjeve më të mëdha mësimore.

Mbaj mend!

Shfrytëzoje kohën e duhur për argëtim!
Mos e tepro, duke lënë anash obligimet e shkollës!

Aktiviteti 4

Kërko në internet këngën, vallen dhe lojën e preferuar, dhe usht-roje për ta realizuar në aktivitete shkollore (shfaqje artistike)! Cilën-do pikë arti a sporti që e pëlqen, mund ta sugjerosh për programin shkollor.

3. TË ECIM ME KUJDES

Krahas të mirave që t`i ofron interneti, ekzistojnë edhe mjaft rreziqe pre e të cilave mund të bëhesh lehtësisht. Prandaj, duhet ecur me kujdes nëpër interent, duke treguar mençuri e zgjuarsi, për t'iu shmangur sjelljeve dhe komunikimeve që të dëmtojnë ty e këdo tjetër përreth teje.

Siç u tha edhe më lart se, komunikimi i keq sjell dhunën, janë edhe një varg elementesh të cilat gjatë përdorimit të internetit mund të rezultojnë me efekte negative dhe mund të paraqesin rrezik të lartë (dhuna digjitale, tra kimi, shfrytëzimi e eksploatimi në forma të ndryshme).

3.1 Dhuna digjitale

Me zhvillimet e mëdha e të shpejta teknologjike, dhuna digjitale është bërë problem global. Dëmet që shkaktohen nga kjo formë e dhunës janë të mëdha si në rrafshin individual, grupor e shoqëror, gjë që përdorimin e internetit e shndërron në burim rreziku.

Mbaj mend!

Dhuna digjitale dhe të gjitha format e dhunës janë të ndaluara dhe të dënueshme me ligjet tona në fuqi dhe me ato ndërkombëtare!

Kohëzgjatja: **30 min.**

3.2 Trafikimi me njerëz



Shpesh fëmijët biejnë pre e mashtrimeve dhe joshjeve nga njerëz të panjohur, prapa të cilëve qëndrojnë rrjete dhe grupe të rrezikshme kriminale. Prandaj, jo rastësisht, sot anë e kënd botës evidentohen raste të kidnapimeve/ grabitjeve, shfrytëzimit të fëmijëve për punë të rrezikshme e të detyrueshme në rrugë, në klube nate e gjetiu për për time të njerëzve të këqinj, të cilët merren me vepra të jashtëligjshme, të dënueshme nga ligjet tona dhe ato ndërkombëtare. Përveç se fëmijët biejnë viktima, ata edhe mund të përfshihen në grupe e rrjete të rrezikshme, duke marrë rolin negativ në kryerjen e veprave të jashtëligjshme.

Duke pasur parasysh rreziqet e tilla nga njerëz kriminalë, të cilët lehtë mund të keqpërdorin fotot e fëmijëve, kontaktet dhe adresat e tyre, duhet të kesh kujdes që gjërat tua (të dhënat, fotot dhe gjendjen tënde emocionale) mos t`i ndash me publikun. Për sigurinë tënde, ndiqi këshillat në vijim!

4. Këshilla të rëndësishme për sigurinë në internet

- Fjalëkalimet dhe të dhënat tjera personale mos i ndaj me të tjerët!
- Mos komuniko me persona të panjohur në internet!
- Kujdes si përfshihesh në rrjetet sociale!
- Kujdes në lojërat online!
- Shmangu nga dhuna digjitale (dhuna kibernetike)!

4.1 Shmangu nga dhuna digjitale

Dhuna digjitale shkaktohet nga njerëz të cilët internetin nuk e përdorin për qëllime të mira, por për të fyer, ngacmuar, kërcënuar, shantazhuar etj.

- Dhuna digjitale (kibernetike) është një formë e re e dhunës e pranishme në gjithë botën.
- Dhuna digjitale (kibernetike) ndalohet me ligj, anipse nuk ka ligj të veçantë vetëm për dhunën digjitale. Ekzitojnë ligje e rregullore të cilat dënojnë të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve, për shirë aty edhe dhunën digjitale.

Mbaj mend!

Dhuna digjitale shkaktohet përmes:
Fyerjes së shoqes/shokut, duke i vënë pseudonime ofenduese nëpërmjet mesazheve, publikimeve në rrjete sociale, përpunimit të fotogra ve të ndryshme, videove etj.
Publikimit të fotogra ve të shoqes/ shokut pa miratimin (lejen) e saj/ tij.
Dërgimit të mesazheve, letrave (e-maileve) me përmbajtje të papërshtatshme (ofenduese, kërcënuese, shantazhuese etj.).
Krijimit të pro leve të pavërteta (të rrejshme).

Aktiviteti 5

Diskuto në klasë për gjendjen emocionale dhe rreziqet që mund të paraqiten, duke qenë viktimë e dhunës digjitale. Shembull:

1. Në adresën e tij elektorike Dreni ka lluar të pranojë letra me përmbajtje të papërshtatshme, të cilat nuk i pëlqe-jnë. Një ditë, Dreni i kthen një përgjigje dërguesit, përmes së cilës i kërkon që mos ta shqetësojë me përmbajtje të tilla. Me gjithë përpjekjen e Drenit, dërguesi nuk ndalet së dëguari, madje llon edhe ta kërcënojë atë për refuzimin.
2. Situatë e njëjtë ndodh me shokun e tij Jonin. Mirëpo, ai diskuton me prindërit dhe mësimdhënësin, para se t`i përgjigjet dërguesit.

Rrumbullakëso çka ndodh me Drenin e çka ndodh Jonin!

- ndihet i frikësuar,
- ndihet i shqetësur,
- thellon komunikimin me dërguesin,
- nuk mund të ejë i qetë,
- nuk mund të koncentrohet në mësime,
- është i lumtur,
- ka krijuar një mik të ri nga interneti (virtual),
- ndryshon sjelljet,
- ka rezultate më të mira në mësime.

Aktiviteti 6

Diskutoje me shokë të klasës de nicionin e dhunës digjitale dhe nxirrni shembuj nga përditshmëria juaj! Më tej hulumtoni mbi ligjet dhe rregulloret që e ndalojnë dhe e dënojnë dhunën digjitale dhe format tjera të dhunës.

Me “Dhunë digjitale” nënkuptojmë çfarëdo forme të dërgimit të mesazheve përmes internetit apo telefonisë mobile, që kanë për qëllim lëndimin, shqetësimin apo që shkaktojnë çfarëdo lloji tjetër të dëmtimit të fëmijës, i cili nuk mund të mbrohet nga veprimet e tilla. Kjo shfaqet në formë të videove apo mesazheve tekstuale, fotogra ve apo thirrjeve.

Mbaj mend!

për secilin ngacmim që përjeton, diskuto me prindër, me mësuesin apo mësuesen. Mos vepro i vetëm!

Mbaj shënime!

Listo disa nga pasojat e dhunës digjitale

4.2 Mos komuniko me persona të panjohur

Komunikimi me persona të panjohur është rrezik i mundshëm për lëndimin, dëmtimin tuaj. Tani që ke arritur moshën e përdorimit të rrjeteve sociale, edhe mundësitë tua për komunikim janë shtuar. Prandaj, duhet të kesh kujdes të shtuar me kë komunikon, me kë lë takime, me kë ndan informata apo kujt i tregon sekrete. Komunikimi me persona të panjohur paraqet rrezik shumë të madh. Nga një komunikim me një të panjohur, që në parim duket i thjeshtë, mund të vijë deri te tra kimi.



Aktiviteti 7

Diskutoni në klasë apo në familje për rreziqet që mund të vijnë nga komunikimi me persona të panjohur në internet.

Mbaj mend!

Komunikimi me të panjohurit rrezikon:
të përjetoni dhunë zike apo digjitale,
keqpërdorim të të dhënave personale,
shqetësim, ulje të rezultateve në mësime.
Mos komuniko me persona të panjohur në internet!
Për çdo shqetësim bisedo me prindërit, mësuesin apo mësuesen!



Mbaj shënime!

Listo rreziqet me sqarime



4.3 Ruaj fjalëkalimet dhe të dhënat tjera personale!

Fjalëkalimi është qelësi i llogarive tua në internet, prandaj duhet të kujdesesh për ruajtjen e fjalëkalimit vetëm për vete. Nëse vëren se dikush e di fjalëkalimin tënd, duhet ta ndryshosh menjëherë atë. Nëse ke më shumë se një llogari (e-mail,

pro l në rrjet social etj.), duhet të përdorësh fjalëkalime të ndryshme për secilën.

Imagjino sikur një i panjohur t`ju ketë parë duke shkruar fjalëkalimin e adresës tënde elekronike, ku i ruan shumë të dhëna për familjen, shkollën etj. Pas pak kohësh ai/ajo do ta hapë adresën tënde, do të shkarkojë fotogra dhe do t'i shpërdajë ato në faqe me përmbajtje të papërshtatshme.

Diskutoni në klasë se si do të ndiheshit, cilat mund të ishin pasojat dhe si duhet mbrojtur nga keqpërdorimet e tilla.

Mbaj mend!

Fjalëkalimi mbron sigurinë tënde në interent.
Ndarja e fjalëkalimit me të tjerët rrezikon sigurinë tënde dhe keqpërdorimin e të dhënave tua personale.
Krijo fjalëkalime të forta, duke kombinuar shkronja, numra dhe simbole.

4.4 Kujdes si përfshihesh në rrjetet sociale!

Rrjetet sociale janë shumë tërheqëse. Aty mund të krijosh shoqëri të re, mund të komunikosh, si dhe të publikosh fotogra , video, audio. Gjithashtu, aty mund të marrësh informacione, të komentosh, të bësh pëlqime, të pëlqehesh, të komentohesh, të vendosesh në qendër të vëmendjes etj. Të bëhesh pjesë e rrjeteve sociale është shumë e lehtë, ngase çdo fëmijë mbi moshën 13 vjeçare mund të krijojë pro lin e vet. Por, duhet të kesh kujdes, meqë përdorimi jo i drejtë i rrjeteve sociale mund të shndërrohet në rrezik për ty dhe për rrethin tënd.

Mbaj mend!

Mos krijo pro l me të dhëna të pavërteta (është e dënueshme për prindin tënd)!
Kujdes çka shkruan dhe çka publikon!
Mos publiko të dhëna, fotogra , audio apo video të shokut/shoqes pa lejen e saj/tij!
Mos fyej në baza etnike, racore, gjinore, religjioze, gjendjeje zike etj.!
Mos prano kërkesa për shoqërim nga personat që nuk i njeh!
Mos i publiko të dhënat personale dhe vendndodhjen tënde!
Informohu për rregullat e privatësisë dhe respektoji ato!

Aktiviteti 8

Lexo dhe analizo de nicionin e tra kimit me njerëz!

Sipas LIGJIT NR. 04/L-218 PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT", tra kimi me njerëz nënkupton rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim të personave, përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo për timeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit"

Pasi ta kesh kesh kuptuar se ç'është tra kimi, listo disa nga veprimet parandaluese që mund të realizohen në shkolla!

Veprime parandaluese që mund të realizohen në shkolla mund të jenë:

- Ligjërata nga profesionistë të fushës
- Ekspozita me temën kundër tra kimit





4.5 Kujdes në lojërat online!

Lojërat online janë pjesë e argëtimit, përmes të cilave mund të për tosh edhe në aspektin edukativo-arsimor. Duhet të kesh kujdes se, krahas argëtimit dhe për timit, mund ta pësosh nga përdorimi i pakontrolluar i tyre.



Aktiviteti 10

Vitin e kaluar, në lëndën e matem-atikës Daorsi mori vlerësimet mak -simale. Gjatë verës ai lloi të luajë online me shokët e lagjes. Lojërat ishin aq tërheqëse, sa që për Daor-sin u shndërruan në prioritet dhe u bën pasion i tij. Sivjet në lëndën e matematikës Daorsi renditet i fundit në vlerësime.

Mbaj mend!

Ku zo kohën e lojës! Loja e tepërt mund të dëmtojë shëndetin tënd psiko- zik.

- Përdorimi i tepruar i lojërave nuk e zhvillon kumunikimin tënd, por e dobëson atë. Nga to mund të kesh shkëputje me rrethin tënd social dhe të bëhesh agresiv, mund të të ulen rezultatet në mësime dhe aktivitete të lira.

Diskuto në klasë se si mund ta ndihmosh Daorsin që të arrijë rezultate të mira sërish. Shëno veprimet që duhet t`i ndërmarrë Daorsi dhe shokët.

Mbaj shënime!

.....

.....

.....

.....

.....



5. Arritja



Duke e përdorë internetin për mësim, lojë, informim dhe komunikim, pa e keqpërdorë atë në asnjë formë që mund të shkaktonte problem a dëm ty apo kujtdo tjetër, do të arrish rezultate të mira në mësime, do të tosh shkathtësi në komunikim e në të shprehur, do të bëhesh krijues (kreativ), do të bëhesh i ditur, do të njihesh me botën që të rrethon dhe do të jesh i dobishëm. Kështu, do të rritesh shëndetshëm dhe përfundimisht do të sillesh përgjegjshëm kudo.

Duke u rritur e zhvilluar në aspektin zik/biologjik (në botën reale), rritesh e zhvillohesh edhe në nivel të njohjes, në nivel intelektual (plotësuar edhe nga qasja e drejtë në botën virtuale), dhe kështu dalëngadalë vjen harmonia e duhur e zhvillimit tënd zik, intelektual, emocional dhe social.

Aktiviteti 11

Inico fushatë vetëdijësuese me aktivitete të larmishme për mbrojtjen e fëmijëve në internet.